

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Mirëmbajtja e automjeteve.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **50112200-5 “Shërbime mirëmbajtje makinash”, 50112110-7 “Shërbime riparimi për automjete”.**

VLERA E FONDIT LIMIT: **2 498 416** (dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme, të lëshuar nga QKB, Kodi VII.3.B.1, për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, që mbulon shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike, të motorit, sistemit elektrik dhe gomave, në përputhje me objektin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me

objektin e kontratës” dhe nenin 41, pika 4, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”.

Kërkesa për disponimin e një licence të vlefshme, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), me Kod VII.3.B.1, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin dhe kërkesat teknike të objektit të prokurimit, i cili konsiston në “Mirëmbajtjen e automjeteve” në administrim të Autoritetit Kontraktor.

Objekti i prokurimit nuk kufizohet vetëm në kryerjen e shërbimeve të zakonshme periodike, por përfshin një sërë ndërhyrjesh të nevojshme për garantimin e funksionimit të rregullt, të sigurt dhe të vazhdueshëm të automjeteve dhe mjeteve të tjera rrugore. Sipas nevojave të përcaktuara në specifikimet teknike, shërbimet përfshijnë, ndër të tjera, ndërrimin e vajrave dhe filtrave, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemit të frenimit, kontrollin dhe riparimin e pjesëve mekanike, mirëmbajtjen e motorit, sistemit të drejtimit, sistemit elektrik, sistemit të kondicionimit, zëvendësimin e gomave dhe baterive, riparimin e sistemit të transmetimit dhe freksionit, si dhe ndërhyrje të tjera teknike që lidhen me funksionimin e automjeteve.

Për më tepër, flota e Autoritetit Kontraktor përfshin automjete të llojeve dhe kapaciteteve të ndryshme, si automjete të lehta, kamionçina, kamionë dhe mjete të tjera të përdorimit të veçantë. Për këtë arsye, mirëmbajtja e tyre kërkon ndërhyrje të specializuara dhe kryerjen e shërbimeve nga një operator ekonomik që ushtron në mënyrë të ligjshme dhe profesionale veprimtarinë e autoriparimit.

Kërkesa për licencën VII.3.B.1 synon të sigurojë që operatori ekonomik i cili do të realizojë kontratën të jetë i pajisur me dokumentacionin profesional të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit dhe të jetë në gjendje të ofrojë shërbimet e kërkuara në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet e nevojshme për mirëmbajtjen e mjeteve rrugore.

Veçanërisht, specialitetet që mbulon kjo licencë lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e parashikuara në objektin e kontratës, pasi përfshijnë riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve mekanike dhe të motorit, karrocërisë, impiantit elektrik, si dhe riparimin dhe mirëmbajtjen e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Këto fusha përkrijnë me kategoritë kryesore të ndërhyrjeve të parashikuara në specifikimet teknike të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri lidhet gjithashtu me nevojën për të garantuar sigurinë teknike të automjeteve. Ndërhyrjet në sistemin e frenimit, motor, sistemin elektrik, sistemin e drejtimit, gomave dhe komponentëve të tjerë mekanikë janë elementë që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e përdorimit të mjeteve. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka interes të sigurohet që këto shërbime të kryhen nga një subjekt i cili ushtron veprimtarinë përkatëse në mënyrë të rregullt dhe profesionale.

Kriteri synon gjithashtu të garantojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve të kryera, duke reduktuar mundësinë e riparimeve të papërshtatshme, dëmtimeve të mëtejshme të mjeteve apo ndërprerjeve të shpeshta të shërbimit. Mirëmbajtja në kohë dhe riparimi korrekt i automjeteve ndikon drejtpërdrejt në zgjatjen e jetëgjatësisë së tyre, uljen e kostove të ndërhyrjeve të paparashikuara dhe mbajtjen e flotës në gjendje të përshtatshme pune.

Ky kriter është veçanërisht i rëndësishëm duke pasur parasysh se automjetet e Autoritetit Kontraktor përdoren për realizimin e shërbimeve publike dhe funksioneve të ndryshme të administrimit vendor. Mosfunksionimi i mjeteve për shkak të mungesës së mirëmbajtjes ose i riparimeve të kryera në mënyrë jo profesionale mund të sjellë ndërprerje të shërbimeve, vonesa në ndërhyrje dhe kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Në këtë kuadër, disponimi i licencës nuk kërkohet si një formalitet i pavarur nga objekti i kontratës, por si një element që lidhet drejtpërdrejt me aftësinë profesionale të operatorit ekonomik për të realizuar shërbimet objekt prokurimi. Kërkesa është përcaktuar në raport me natyrën e shërbimeve që do të kryhen dhe me nevojën për të garantuar realizimin e tyre në mënyrë të sigurt, profesionale dhe të kontrollueshme.

Për sa më sipër, kërkesa që operatori ekonomik të disponojë licencën e vlefshme VII.3.B.1 për autoriparin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, e cila mbulon specialitetet përkatëse të riparimit dhe mirëmbajtjes, konsiderohet e nevojshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit “Mirëmbajtja e automjeteve”, pasi garanton që subjekti kontraktues të ketë të drejtën dhe kapacitetin profesional për të ushtruar veprimtarinë përkatëse dhe për të realizuar shërbimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Nëpërmjet këtij kriteri synohet të sigurohet njëkohësisht siguria e automjeteve, cilësia e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit, vazhdimësia e funksionimit të flotës dhe realizimi i rregullt i shërbimeve publike, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike dhe në dokumentet e procedurës së prokurimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP të ndryshuar, nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ” 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të

tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.* Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.*

Në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.*

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e*

nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”, nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e shërbimeve të ngjashme me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 3 (tre) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

Listëpagesës sipas formularit standart për sigurimet për muajin Gusht 2026.

Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për muajin Gusht 2026.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/ b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kërkesa për disponimin e një fuqie punëtore prej minimalisht 3 (tre) persona është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, i cili konsiston në

“Mirëmbajtjen e automjeteve”, si dhe llojin dhe numrin e automjeteve që do të mirëmbahen gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Shërbimet objekt kontrate nuk kufizohen vetëm në mirëmbajtjen periodike të automjeteve, por përfshijnë një gamë të gjerë ndërhyrjesh teknike, si ndërrimi i vajrave dhe filtrave, kontrolli dhe riparimi i sistemit të frenimit, mirëmbajtja dhe riparimi i motorit, sistemit mekanik, sistemit elektrik, sistemit të drejtimit, sistemit të kondicionimit, zëvendësimi i gomave dhe baterive, ndërhyrje në sistemin e transmetimit dhe freksionit, si dhe ndërhyrje të tjera të nevojshme sipas gjendjes teknike të automjeteve.

Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, realizimi i kontratës kërkon që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një numër të mjaftueshëm punonjësish për të organizuar dhe kryer në mënyrë efektive ndërhyrjet e mirëmbajtjes dhe riparimit. Disponimi i të paktën tre punonjësve krijon mundësinë për ndarjen dhe organizimin e punës sipas natyrës së ndërhyrjeve, duke mundësuar që shërbimet mekanike, elektrike, të gomave dhe ndërhyrjet e tjera të kryhen në mënyrë të koordinuar dhe brenda afateve të kërkuara.

Ky numër minimal i fuqisë punëtore është i nevojshëm gjithashtu për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit dhe reagimin në kohë, veçanërisht në rastet kur paraqiten defekte të papritura ose kërkojnë ndërhyrje urgjente. Duke qenë se automjetet përdoren për realizimin e shërbimeve publike, qëndrimi i tyre për periudha të gjata jashtë funksionit mund të ndikojë në realizimin normal të detyrave të Autoritetit Kontraktor.

Disponimi i një stafi minimal prej tre personash i jep operatorit ekonomik mundësinë të përballojë njëkohësisht nevoja të ndryshme për mirëmbajtje, të reduktojë kohën e qëndrimit të automjeteve në servis dhe të sigurojë një organizim më të mirë të punës gjatë periudhës së zbatimit të kontratës. Kriteri lidhet drejtpërdrejt me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, pasi disponimi i personelit të nevojshëm përbën një element të rëndësishëm për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së automjeteve. Punonjësit duhet të jenë në gjendje të kryejnë ndërhyrjet e parashikuara në specifikimet teknike dhe të përdorin pajisjet dhe mjetet e nevojshme për realizimin e shërbimeve.

Përcaktimi i numrit minimal prej 3 (tre) punonjësish është bërë në raport me nevojat konkrete të kontratës dhe nuk synon kërkimin e një numri të pajustifikuar punonjësish. Ky numër konsiderohet i nevojshëm për të siguruar kapacitetin minimal operacional të operatorit ekonomik për përballimin e shërbimeve të mirëmbajtjes, duke marrë në konsideratë numrin dhe llojin e automjeteve, shumëllojshmërinë e ndërhyrjeve dhe nevojën për reagim të shpejtë.

Kërkesa për paraqitjen e listëpagesës për muajin Gusht 2026 dhe të vërtetimit nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për të njëjtin muaj synon të verifikojë në mënyrë objektive dhe të dokumentuar disponimin real të fuqisë punëtore të deklaruar nga operatori ekonomik. Këto dokumente i mundësojnë Autoritetit Kontraktor të verifikojë përputhjen ndërmjet vetëdeklarimit të operatorit ekonomik dhe dokumentacionit zyrtar për punonjësit e deklaruar.

Kërkesa për vetëdeklarimin e fuqisë punëtore në fazën e ofertimit dhe paraqitjen e dokumentacionit provues nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje synon të sigurojë një proces verifikimi të qartë dhe transparent të këtij kapaciteti, pa krijuar ngarkesë të panevojshme dokumentare për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Për sa më sipër, kriteri për disponimin e një fuqie punëtore prej minimalisht 3 (tre) persona është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit “Mirëmbajtja e automjeteve” dhe me nevojën për të

garantuar realizimin e shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme, profesionale, cilësore dhe brenda afateve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Kriteri synon të garantojë kapacitetin minimal njerëzor të nevojshëm për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, reduktimin e kohës së qëndrimit të tyre jashtë shërbimit dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon një servis të licencuar për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor, i cili ndodhet në një distancë jo më të madhe se 50 (pesëdhjetë) km nga qyteti i Himarës (distanca prej 50 km do të konsiderohet si distancë rrugore nga qyteti i Himarës deri në adresën e servisit të deklaruar nga Operatori Ekonomik).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kërkesa për disponimin e një servisi të licencuar për autoriparimin e mjeteve rrugore në një distancë jo më të madhe se 50 km nga qyteti i Himarës është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në “Mirëmbajtjen e automjeteve”, si dhe nevojën e Autoritetit Kontraktor për të garantuar kryerjen në kohë dhe me efektivitet të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të flotës së automjeteve.

Automjetet në administrim të Autoritetit Kontraktor përdoren në mënyrë të vazhdueshme për realizimin e shërbimeve publike dhe, për këtë arsye, është e nevojshme që ndërhyrjet për mirëmbajtjen periodike, riparimet dhe zëvendësimin e pjesëve të kryhen brenda një distance të arsyeshme nga qyteti i Himarës.

Kërkesa për një servis brenda një distance maksimale prej 50 km synon të sigurojë akses të shpejtë në shërbimin e mirëmbajtjes dhe riparimit, duke reduktuar kohën e transportit të automjeteve drejt servisit dhe kthimit të tyre në përdorim. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për rastet e defekteve të papritura apo ndërhyrjeve urgjente, kur vonesa në riparim mund të ndikojë drejtpërdrejt në vazhdimësinë e shërbimeve publike.

Flota e Autoritetit Kontraktor përfshin automjete të ndryshme, ndër të cilat automjete të lehta, kamionçina, kamionë dhe mjete të tjera pune, për të cilat specifikimet teknike parashikojnë ndërhyrje në sistemin mekanik, motorik, të frenimit, elektrik, të drejtimit, sistemin e kondicionimit, gomat, sistemet hidraulike dhe komponentë të tjerë. Për realizimin e këtyre ndërhyrjeve kërkohet që operatori ekonomik të ketë akses në një strukturë servisi të përshtatshme dhe të licencuar, me kapacitetet e nevojshme teknike.

Disponimi i servisit në një distancë të përcaktuar nga Himara nuk synon kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në bazë të vendndodhjes së selisë së tyre, por lidhet me mundësinë reale dhe efektive të ekzekutimit të kontratës, duke garantuar që shërbimet të ofrohen në kohë dhe që automjetet të rikthehen sa më shpejt në funksion.

Kriteri është veçanërisht i rëndësishëm për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike, pasi qëndrimi i automjeteve për periudha të gjata jashtë funksionit mund të shkaktojë vonesa ose ndërprerje në realizimin e detyrave të Autoritetit Kontraktor. Një distancë e arsyeshme nga Himara mundëson reagim më të shpejtë të operatorit ekonomik dhe redukton kohën e nevojshme për transportimin e mjeteve drejt servisit.

Gjithashtu, disponimi i një servisi të licencuar synon të garantojë që ndërhyrjet teknike të kryhen nga një subjekt që ushtron veprimtarinë përkatëse në mënyrë të ligjshme dhe profesionale dhe që disponon kushtet e nevojshme për realizimin e shërbimeve të kërkuara. Kjo lidhet drejtpërdrejt me kërkesën për cilësi, siguri dhe besueshmëri të mirëmbajtjes së automjeteve.

Përcaktimi i kufirit prej 50 km është vendosur në funksion të nevojës për të krijuar një ekuilibër ndërmjet aksesit efektiv dhe të shpejtë në shërbim dhe mundësisë së operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në procedurë. Distanca lidhet me vendndodhjen e Autoritetit Kontraktor dhe me nevojën që automjetet të transportohen në servis dhe të rikthehen në përdorim brenda një kohe të arsyeshme.

Kërkesa për disponimin e një servisi të licencuar jo më larg se 50 km nga Himara konsiderohet e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me nevojën për garantimin e realizimit të shërbimeve të mirëmbajtjes në mënyrë të shpejtë, cilësore dhe të vazhdueshme. Kriteri synon në mënyrë të veçantë uljen e kohës së qëndrimit të automjeteve jashtë shërbimit, reagimin ndaj defekteve dhe ndërhyrjeve urgjente, reduktimin e kostove dhe kohës së transportit dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike.

Në këtë kuadër, kriteri lidhet me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën dhe me nevojën e Autoritetit Kontraktor për të siguruar një shërbim të aksesueshëm dhe të disponueshëm gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon, në pronësi ose nëpërmjet një forme të ligjshme përdorimi, të paktën 1 (një) karroatrec, i cili do të jetë në dispozicion gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, për transportimin/tërheqjen e automjeteve të Autoritetit Kontraktor në rast defekti, avarie ose pamundësie për të lëvizur në mënyrë autonome.

Karroatreci duhet të jetë i përshtatshëm për transportin dhe tërheqjen e kategorive të automjeteve objekt të shërbimit të mirëmbajtjes dhe të plotësojë kërkesat teknike dhe ligjore përkatëse për qarkullim dhe përdorim.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon pronësinë ose disponimin e ligjshëm të mjetit, si dhe dokumentacionin e vlefshëm të mjetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Në rast se karroatreci nuk është në pronësi të operatorit ekonomik, disponimi i tij mund të dëshmohet nëpërmjet kontratës së qirasë, huapërdorjes, marrëveshjes së bashkëpunimit ose dokumenti tjetër të vlefshëm juridik, nga i cili rezulton qartë e drejta e operatorit ekonomik për përdorimin e mjetit gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të garantojë që karroatreçi të jetë në dispozicion për nevojat e Autoritetit Kontraktor gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës, pasi shërbimi i mirëmbajtjes së automjeteve nuk kufizohet vetëm në kryerjen e ndërhyrjeve periodike dhe riparimeve në ambientet e servisit, por përfshin edhe mundësinë e transportimit ose tërheqjes së mjeteve të Autoritetit Kontraktor në rastet kur, për shkak të një defekti teknik, avarie, dëmtimi apo problematike tjetër mekanike, ato nuk janë në gjendje të lëvizin në mënyrë autonome.

Nga analiza e mjeteve që përfshihen në objektin e shërbimit rezulton se flota e Autoritetit Kontraktor përbëhet nga mjete të kategorive dhe përmasave të ndryshme, konkretisht automjete të lehta, si Mitsubishi dhe Mitsubishi L200, kamionë dhe kamioncina, përfshirë Mercedes Benz Atego dhe mjete Iveco, kamion me kazan, mjete të rënda të punës, përfshirë fadroma dhe eskavator me zinxhir.

Shërbimet e parashikuara për këto mjete përfshijnë ndërhyrje në sisteme të ndryshme mekanike dhe teknike, si sistemi i frenimit, motori, sistemi hidraulik, sistemi i transmetimit, sistemi i ftohjes/kondicionimit, ndërrimi i vajrave dhe filtrave, riparimi i motorit, zëvendësimi i gomave, baterive, tubove hidraulikë dhe komponentëve të tjerë.

Për shkak të natyrës së këtyre mjeteve dhe të shërbimeve të kërkuara, nuk mund të përjashtohet mundësia që një automjet të pësojë avari ose defekt gjatë përdorimit dhe të mos jetë më në gjendje të lëvizë në mënyrë autonome. Në një situatë të tillë, për realizimin efektiv të kontratës është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë mundësinë e sigurimit të transportit/tërheqjes së mjetit deri në ambientet ku do të kryhet diagnostikimi dhe riparimi.

Disponimi i karroatrecit siguron që shërbimi i mirëmbajtjes të mos kufizohet vetëm në momentin e riparimit, por të garantojë edhe mundësinë e marrjes, transportimit dhe sjelljes së mjetit për shërbim, kur ai nuk mund të lëvizë vetë.

Kërkesa është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se në flotën objekt të kontratës përfshihen mjete me përmasa, peshë dhe karakteristika teknike të ndryshme, përfshirë kamionë dhe mjete të rënda pune. Për këto mjete, një defekt i rëndë mund të pamundësojë lëvizjen e tyre dhe transportimi i tyre kërkon përdorimin e një mjeti të përshtatshëm për tërheqje/transport.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor e konsideron disponimin e të paktën një karroatreçi si një kapacitet teknik të nevojshëm për garantimin e vazhdimësisë dhe efektivitetit të shërbimit të mirëmbajtjes, si dhe për shmangien e vonësive në marrjen e mjeteve të dëmtuara apo të avaruara. Kërkesa është përcaktuar në nivelin minimal të nevojshëm, duke kërkuar vetëm 1 (një) karroatrec, dhe nuk është kërkuar që ky mjet të jetë domosdoshmërisht në pronësi të operatorit ekonomik. Për të mos kufizuar konkurrencën, është parashikuar mundësia që operatori ekonomik ta disponojë atë edhe nëpërmjet një forme tjetër të ligjshme përdorimi, si qiraja, huapërdorja, marrëveshja e bashkëpunimit apo një dokument tjetër juridik i vlefshëm.

Gjithashtu, nuk është përcaktuar një markë, model apo karakteristikë specifike që do të favorizonte një operator ekonomik të caktuar. Kërkesa kufizohet në faktin që karroatreçi të jetë i përshtatshëm për kategoritë e mjeteve objekt të kontratës dhe të plotësojë kërkesat teknike dhe ligjore përkatëse. Në këtë mënyrë, kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik i përzgjedhur të ketë kapacitetin real për të përballuar jo vetëm riparimin e automjeteve, por edhe situatat kur mjeti i dëmtuar nuk mund të transportohet vetë deri në ambientet e servisit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, të paktën 2 (dy) gropa shërbimi për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, me gjatësi minimale 10 (dhjetë) metra secila, të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve objekt të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon disponimin e ligjshëm të ambienteve, në pronësi ose nëpërmjet qirasë, huapërdorjes apo një forme tjetër të ligjshme disponimi, për të gjithë periudhën e nevojshme për realizimin e kontratës.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë, gjithashtu, fotografi të qarta dhe aktuale të të dyja gropave të shërbimit, nga të cilat të mund të identifikohet ekzistenca fizike e tyre, numri i gropave, karakteristikat dhe përshtatshmëria e tyre për kryerjen e shërbimeve objekt kontrate.

Fotografite duhet të paraqesin në mënyrë të dallueshme ambientet dhe gropat e shërbimit, duke mundësuar lidhjen e tyre me adresën/ambientin e deklaruar nga Operatori Ekonomik.

Autoriteti Kontraktor, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të verifikojë gjatë procesit të vlerësimit ekzistencën dhe përputhshmërinë e ambienteve dhe pajisjeve të deklaruara, përfshirë verifikimin fizik në vend, kur një verifikim i tillë konsiderohet i nevojshëm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumin dhe kompleksitetin teknik të shërbimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës, si dhe me karakteristikat e flotës së automjeteve të Autoritetit Kontraktor.

Flota që përfshihet në objektin e mirëmbajtjes nuk përbëhet vetëm nga automjete të lehta, por përfshin kategori të ndryshme mjetesh, ndër të cilat automjete të lehta, përfshirë Mitsubishi dhe Mitsubishi L200, kamionë dhe kamioncina, përfshirë Mercedes Benz Atego dhe mjete Iveco, kamion me kazan, fadroma dhe eskavator me zinxhir.

Nga shërbimet e parashikuara në objektin e kontratës rezulton se ndërhyrjet teknike nuk kufizohen vetëm në shërbime të thjeshta periodike, por përfshijnë ndërhyrje në sisteme të ndryshme të mjeteve, si sistemi i frenimit, motori, sistemi i transmisionit, sistemi hidraulik, pjesët e poshtme të automjeteve, zëvendësimi i komponentëve mekanikë, kontrolli i pjesëve të drejtimit dhe shërbime të tjera të mirëmbajtjes.

Për kryerjen e një pjese të konsiderueshme të këtyre ndërhyrjeve teknike, veçanërisht në automjetet e tonazhit të lartë dhe mjetet e punës, është e nevojshme që mjetet të pozicionohen në ambiente të përshtatshme pune, të cilat mundësojnë aksesin teknik në pjesët e poshtme të tyre.

Gjatësia minimale prej 10 metrash është përcaktuar duke marrë në konsideratë përmasat dhe gjatësinë e mjeteve që përfshihen në objektin e kontratës, veçanërisht kamionët dhe kamioncinat, për të siguruar që mjeti të mund të pozicionohet në mënyrë të përshtatshme mbi/mbi hapësirën e punës dhe që personeli teknik të ketë akses të mjaftueshëm për kryerjen e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes dhe riparimit.

Kërkesa për dy gropa shërbimi lidhet me nevojën për të garantuar kapacitet të mjaftueshëm teknik dhe organizativ për realizimin e shërbimeve, duke mundësuar kryerjen e ndërhyrjeve në më shumë se një automjet në mënyrë të njëkohshme ose vijueshme, si dhe duke shmangur krijimin e pengesave dhe vonesave në procesin e mirëmbajtjes.

Disponimi i dy gropave krijon mundësinë që, ndërkohë që një mjet i nënshtrohet një ndërhyrjeje më të gjatë ose më komplekse, të mund të kryhet paralelisht shërbimi teknik për një mjet tjetër, duke garantuar një organizim më efikas të punës dhe duke reduktuar kohën gjatë së cilës automjetet e Autoritetit Kontraktor qëndrojnë jashtë përdorimit.

Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme për shkak të numrit dhe diversitetit të mjeteve objekt të kontratës, si dhe të natyrës së shërbimeve të parashikuara, të cilat përfshijnë ndërhyrje të ndryshme në sistemet mekanike dhe teknike të mjeteve.

Kërkesa nuk lidhet me një markë apo model specifik automjeti dhe nuk përcakton karakteristika që favorizojnë një operator ekonomik të caktuar. Ajo përcakton vetëm kapacitetin minimal teknik të ambienteve të nevojshme për realizimin e shërbimit, duke i lënë operatorëve ekonomikë mundësinë që këtë kapacitet ta disponojnë në pronësi, me qira, huapërdorje apo nëpërmjet një forme tjetër të ligjshme disponimi.

Gjithashtu, kërkesa për paraqitjen e fotografive të qarta dhe aktuale të dy gropave të shërbimit ka për qëllim të mundësojë verifikimin e ekzistencës fizike të kapacitetit të deklaruar dhe të shmangë deklaratimet formale për ambiente që nuk ekzistojnë ose nuk janë të përshtatshme për realizimin e shërbimit. Fotografitë shërbejnë si dokumentacion plotësues i provës së disponimit ligjor të ambientit dhe duhet të mundësojnë identifikimin e qartë të ambienteve të deklaruara.

Autoriteti Kontraktor, në rast nevojë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të verifikojë ekzistencën fizike dhe përshtatshmërinë e ambienteve të deklaruara nga operatori ekonomik.

Përcaktimi i kërkesës në nivelin minimal prej dy gropash shërbimi me gjatësi minimale 10 metra secila është bërë në funksion të garantimit të kapacitetit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, duke marrë në konsideratë llojin, numrin, përmasat dhe karakteristikat e mjeteve që do t'i nënshtrohen mirëmbajtjes, si dhe natyrën e shërbimeve të kërkuara.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon, për realizimin e shërbimeve objekt të kontratës, të paktën 2 (dy) punonjës/personel teknik të kualifikuar, si më poshtë:

- 1. 1 (një) specialist të mirëmbajtjes industriale – xhenerik, i pajisur me certifikatën përkatëse të kualifikimit profesional “Specialist i mirëmbajtjes industriale – xhenerik”, të lëshuar nga një institucion/organ kompetent dhe të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi;*
- 2. 1 (një) specialist për servisimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të automjeteve të lehta, i pajisur me certifikatën përkatëse të kualifikimit profesional për servis motorri në automjetet e lehta, të lëshuar nga një institucion/organ kompetent dhe të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- dokumenti që provon disponimin e tij nga Operatori Ekonomik;*
- kopje e certifikatës së kualifikimit profesional;*
- dokumentacion tjetër që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të provuar vlefshmërinë e kualifikimit/certifikimit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kërkesa për personel të kualifikuar lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që do të kryhen, pasi kontrata nuk kufizohet vetëm në kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes periodike, por përfshin një gamë të gjerë ndërhyrjesh teknike dhe mekanike në automjete dhe mjete pune të kategorive të ndryshme.

Në flotën objekt të kontratës përfshihen automjete të lehta, kamionë, kamioncina, kamion me kazan, si dhe mjete të rënda pune, përfshirë fadroma dhe eskavator me zinxhir. Për rrjedhojë, realizimi i shërbimeve kërkon njohuri dhe aftësi profesionale në fusha të ndryshme të mirëmbajtjes dhe riparimit mekanik.

Nga shërbimet e përcaktuara në objektin e kontratës rezulton se kërkohen, ndër të tjera, ndërhyrje dhe shërbime në:

- motorë dhe komponentë të motorit;
- sistemet e frenimit;
- sistemet e transmetimit;
- komponentët e drejtimit dhe të suspensionit;
- ndërrimin dhe kontrollin e vajrave dhe filtrave;
- riparimin e motorit;
- sistemet hidraulike të mjeteve të rënda;
- tubacionet dhe komponentët hidraulikë;
- sistemet e kompresimit të ajrit;
- sistemet e kondicionimit;
- ndërrimin e gomave dhe baterive;
- komponentë të ndryshëm mekanikë dhe xhenerikë.

Për realizimin e këtyre shërbimeve në mënyrë të sigurt, korrekte dhe profesionale është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në dispozicion personel teknik me kualifikim të përshtatshëm për llojin e ndërhyrjeve që parashikohen në kontratë.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kërkesë minimale disponimin e:

1. Një specialisti të mirëmbajtjes industriale – xhenerik, i pajisur me certifikatën përkatëse të kualifikimit profesional. Kërkesa për këtë profil lidhet me nevojën për të realizuar ndërhyrje dhe shërbime të karakterit mekanik dhe xhenerik në automjete dhe veçanërisht në mjetet e punës dhe mjetet e tonazhit të lartë, ku kërkohet njohje e komponentëve mekanikë, sistemeve të mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve teknike. Duke pasur parasysh përfshirjen në kontratë të mjeteve të tilla si Mercedes Benz Atego, automjeteve Iveco, kamionit me kazan, fadromave dhe eskavatorit, disponimi i një specialisti me kualifikim në mirëmbajtjen industriale dhe profilin xhenerik është i nevojshëm për të garantuar kapacitetin profesional për ndërhyrjet mekanike dhe teknike që kërkojnë këto mjete.

2. Një specialisti për servisimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të automjeteve të lehta, i pajisur me certifikatën përkatëse të kualifikimit profesional. Kërkesa për këtë profil lidhet me faktin se në flotën e Autoritetit Kontraktor përfshihen edhe automjete të lehta, ndër të cilat automjete Mitsubishi dhe Mitsubishi L200, për të cilat parashikohen shërbime të mirëmbajtjes së motorit, ndërrim vajrash dhe filtrash, ndërhyrje në sistemet e motorit dhe riparime të tjera të lidhura me funksionimin e motorit. Disponimi i personelit me këtë kualifikim siguron që shërbimet për automjetet e lehta të kryhen nga personel që disponon formimin dhe certifikimin profesional të nevojshëm për këtë kategori shërbimesh.

Përcaktimi i dy punonjësve me profile të ndryshme profesionale është bërë për të mbuluar nevojat teknike të kategorive të ndryshme të mjeteve që përfshihen në kontratë dhe për të siguruar që operatori ekonomik të ketë kapacitet profesional të mjaftueshëm për realizimin e shërbimeve të kërkuara.

Kërkesa është përcaktuar në nivelin minimal të nevojshëm, duke kërkuar vetëm 1 (një) specialist për secilin profil, dhe nuk përcakton një numër më të lartë punonjësish sesa ai që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt kontrate.

Kërkesa për certifikim profesional synon të sigurojë që personeli i angazhuar në realizimin e shërbimeve të ketë një nivel të dokumentuar të kompetencës profesionale dhe të jetë në gjendje të kryejë ndërhyrjet teknike sipas profilit përkatës.

Për të shmangur krijimin e një barre të panevojshme administrative gjatë fazës së ofertimit, është parashikuar që operatorët ekonomikë të vetëdeklarojnë disponimin e personelit minimal të kërkuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues t'i kërkohej operatorit ekonomik të kualifikuar i pari në renditje, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor siguron verifikimin e mëvonshëm të kapacitetit profesional të operatorit ekonomik të renditur i pari, pa vendosur kërkesa të panevojshme dokumentare për të gjithë operatorët ekonomikë në fazën fillestare të procedurës.

Dokumentacioni provues që kërkohej përfshin dokumentin që provon disponimin e personelit nga operatori ekonomik, kopjen e certifikatës përkatëse të kualifikimit profesional dhe dokumentacionin tjetër të kërkuar nga legjislacioni në fuqi për verifikimin e vlefshmërisë së kualifikimit/certifikimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë gjendjen teknike, llojin, karakteristikat dhe mënyrën e përdorimit të automjeteve dhe makinerive në administrim të Autoritetit Kontraktor, si dhe nevojën për garantimin e funksionimit të tyre të rregullt, të sigurt dhe të vazhdueshëm.

Automjetet dhe makineritë në administrim të Autoritetit Kontraktor përdoren për kryerjen e shërbimeve dhe funksioneve të ndryshme publike. Për këtë arsye, mirëmbajtja e tyre në kohë dhe kryerja e ndërhyrjeve të nevojshme teknike janë të domosdoshme për shmangien e defekteve, uljen e kohës së qëndrimit të mjeteve jashtë funksionit, garantimin e sigurisë në përdorim dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike.

Specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë që të mbulojnë nevojat e parashikueshme dhe ato që mund të evidentohen gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, pa përcaktuar një markë, model apo prodhues specifik për pjesët e këmbimit, por duke kërkuar përputhshmëri me karakteristikat teknike të çdo mjeti dhe kërkesat e prodhuesit.

1. Mirëmbajtja periodike

Kërkesat për mirëmbajtjen periodike janë përcaktuar për të garantuar kryerjen e kontrolleve dhe shërbimeve bazë që nevojiten për mbajtjen e automjeteve dhe makinerive në gjendje të përshtatshme pune.

Ndërrimi i vajit të motorit dhe i filtrave të vajit, ajrit, karburantit dhe kabinës/kondicionerit është i nevojshëm për funksionimin normal të motorit dhe sistemeve përkatëse, për ruajtjen e parametrave të punës dhe për reduktimin e konsumimit të parakohshëm të komponentëve.

Kontrolli i sistemit të frenimit, drejtimit dhe paralelizmit lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e automjeteve. Ndërhyrjet në këto sisteme kërkojnë kontroll periodik për të evidentuar në kohë konsumimin ose dëmtimin e komponentëve dhe për të shmangur rrezikun e defekteve gjatë përdorimit.

Kontrolli i sistemit të ftohjes, sistemit elektrik, baterive dhe sistemit të karikimit është i nevojshëm për të parandaluar mbinxehjen e motorit, problemet e ndezjes dhe defektet elektrike që mund të sjellin ndërprerjen e funksionimit të mjetit.

Për makineritë e rënda, kontrolli i sistemit hidraulik, vajrave teknikë dhe lubrifikimi me graso janë të domosdoshme për funksionimin normal të komponentëve hidraulikë dhe mekanikë, duke reduktuar konsumimin dhe mundësinë e defekteve.

Kontrolli i gjendjes së gomave është përcaktuar për të garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e mjetit gjatë lëvizjes dhe punës, ndërsa diagnostikimi teknik mundëson identifikimin në kohë të defekteve dhe përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme.

Për këtë arsye, elementët e mirëmbajtjes periodike janë përfshirë në specifikimet teknike si pjesë e domosdoshme e shërbimit të mirëmbajtjes së flotës.

2. Riparimet dhe ndërhyrjet teknike

Këto kërkesa janë përcaktuar duke marrë në konsideratë faktin se gjatë përdorimit të vazhdueshëm të automjeteve dhe makinerive mund të shfaqen defekte ose konsumim i komponentëve që nuk mund të përcaktohen paraprakisht.

Ndërhyrjet në sistemin e frenimit, zëvendësimi i elementeve të frenave dhe disqeve, riparimi i motorit, transmisionit dhe sistemit të drejtimit janë të nevojshme për rikthimin e mjeteve në gjendje normale dhe të sigurt pune.

Zëvendësimi i kokave të paralelit dhe elementeve të tjera të drejtimit lidhet me nevojën për ruajtjen e kontrollit dhe qëndrueshmërisë së automjetit. Po kështu, zëvendësimi i gomave dhe baterive është parashikuar për rastet kur këto komponentë nuk plotësojnë më kushtet e nevojshme për përdorim.

Për makineritë e rënda janë parashikuar ndërhyrje në sistemin hidraulik, duke përfshirë tubot, pistonët dhe komponentët e tjerë hidraulikë. Këto ndërhyrje janë të nevojshme për shkak të ngarkesës së punës dhe kushteve në të cilat përdoren këto makineri.

Përfshirja e mundësisë për riparime të tjera mekanike, elektrike ose hidraulike lidhet me natyrën e mirëmbajtjes, pasi defektet nuk mund të parashikohen të gjitha në mënyrë shtues në momentin e hartimit të specifikimeve teknike. Çdo ndërhyrje e tillë do të përcaktohet në bazë të diagnostikimit dhe nevojës reale të mjetit dhe do të kryhet në përputhje me kushtet e kontratës.

3. Vajrat dhe materialet lubrifikuese

Kërkesat për vajrat e motorit, transmisionit, diferencialit dhe sistemit hidraulik janë përcaktuar për të garantuar përdorimin e materialeve që janë të përshtatshme për karakteristikat teknike të çdo automjeti ose makinerie.

Përdorimi i vajit me viskozitet dhe klasifikim të përshtatshëm është i rëndësishëm për lubrifikimin korrekt të komponentëve, reduktimin e fërkimit dhe konsumimit dhe ruajtjen e parametrave normalë të funksionimit.

Për makineritë e rënda, përdorimi i vajit hidraulik të përshtatshëm është i nevojshëm për funksionimin e pompave, cilindrave, tubacioneve dhe komponentëve të tjerë të sistemit hidraulik. Kërkesa që vajrat të jenë në përputhje me kërkesat teknike të mjetit synon të shmangë përdorimin e materialeve të papërshtatshme dhe të sigurojë që shërbimi të kryhet sipas parametrave teknikë të përcaktuar për secilin mjet.

Përcaktimi i specifikimeve si 80W-90, ISO VG 68 ose ekuivalent teknik bëhet në funksion të nevojës për të përcaktuar karakteristikat teknike të materialit dhe jo për të kufizuar konkurrencën ndaj një produkti ose prodhuesi të caktuar.

4. Filtrat

Filtrat janë komponentë të rëndësishëm për mbrojtjen e motorit dhe sistemeve të automjetit nga papastërtitë dhe elementët e dëmshëm.

Kërkesa që filtrat e vajit, ajrit, naftës, kabinës, kondicionerit dhe kompresorit të ajrit të jenë të rinj dhe të papërdorur synon të garantojë cilësinë dhe efektivitetin e shërbimit.

Kërkesa për kompatibilitet me mjetin përkatës dhe përmbushjen e parametrave teknikë të kërkuar nga prodhuesi është e nevojshme për të garantuar përshtatjen e filtrit me sistemin ku do të instalohet dhe funksionimin normal të tij.

Përcaktimi i këtyre kërkesave lidhet me nevojën për të parandaluar përdorimin e pjesëve të papërshtatshme ose të cilësisë së pamjaftueshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në funksionimin e automjetit dhe në jetëgjatësinë e komponentëve të tij.

5. Sistemi i frenimit

Sistemi i frenimit është një nga sistemet kryesore të sigurisë së automjetit. Për këtë arsye, pjesët dhe shërbimet që lidhen me këtë sistem janë përfshirë në specifikimet teknike me qëllim garantimin e funksionimit të sigurt të mjeteve.

Parashikimi i elementeve të frenimit para dhe pas, disqeve, pompave të frenave dhe elementeve të tjera të sistemit mundëson kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme në varësi të gjendjes teknike të çdo automjeti.

Pas çdo ndërhyrjeje në sistemin e frenimit kërkohet kontrolli funksional i tij, me qëllim që mjeti të rikthehet në përdorim vetëm pasi të jetë verifikuar funksionimi i përshtatshëm i sistemit.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e drejtuesve, punonjësve dhe personave të tjerë që mund të jenë në afërsi të automjeteve gjatë përdorimit të tyre.

6. Gomat

Gomat janë elementë të rëndësishëm për sigurinë, stabilitetin dhe lëvizshmërinë e automjeteve. Për këtë arsye, është përcaktuar që gomat e zëvendësuara të jenë të reja dhe të përshtatshme për llojin e automjetit ose makinerisë.

Kërkesat për dimensionet, indeksin e ngarkesës, indeksin e shpejtësisë, tipologjinë e përdorimit dhe kushtet e terrenit janë përcaktuar për të garantuar që goma e përzgjedhur të jetë teknologjikisht e përshtatshme për mjetin dhe mënyrën e përdorimit të tij.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për automjetet që përdoren në kushte të ndryshme pune dhe për makineritë që operojnë në terrene pune, ku kërkohet përshtatshmëri e gomave me ngarkesën dhe kushtet e përdorimit.

7. Mirëmbajtja e makinerive të rënda

Makineritë e rënda, si fadromat dhe eskavatorët, kanë sisteme dhe komponentë të ndryshëm nga automjetet e zakonshme dhe kërkojnë ndërhyrje specifike teknike.

Kërkesat për ndërrimin e vajit të motorit dhe filtrave, kontrollin dhe zëvendësimin e vajit hidraulik, kontrollin e pistonëve dhe cilindrave, zëvendësimin e tubove hidraulikë, lubrifikimin e nyjeve dhe kontrollin e sistemit të transmetimit janë përcaktuar duke marrë në konsideratë mënyrën e funksionimit dhe ngarkesën e punës së këtyre makinerive.

Mirëmbajtja e sistemit hidraulik është veçanërisht e rëndësishme për funksionimin e pajisjeve të punës së makinerive. Defektet në këtë sistem mund të shkaktojnë ndërprerje të menjëhershme të punës dhe dëmtime të komponentëve të tjerë.

Për këtë arsye, parashikimi i këtyre shërbimeve synon të sigurojë funksionimin e vazhdueshëm dhe të sigurt të makinerive dhe të reduktojë kohën e qëndrimit të tyre jashtë pune.

8. Kërkesat për cilësinë e shërbimit

Kërkesa që shërbimet të kryhen nga personel teknik i kualifikuar dhe me përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme lidhet me kompleksitetin e ndërhyrjeve të parashikuara në kontratë.

Ndërhyrjet e kryera në mënyrë jo të përshtatshme mund të shkaktojnë dëmtime të mëtejshme të automjetit ose makinerisë dhe të sjellin kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor. Për këtë arsye, është përcaktuar që çdo ndërhyrje të realizohet në mënyrë profesionale dhe pa shkaktuar dëmtime të mëtejshme.

Kërkesa për dorëzimin e mjetit në gjendje të përshtatshme për përdorim dhe kryerjen e kontrolleve funksionale pas ndërhyrjeve synon të garantojë që shërbimi i kryer të përmbushë qëllimin për të cilin është kërkuar.

9. Diagnostikimi dhe përcaktimi i ndërhyrjeve

Jo të gjitha defektet e automjeteve dhe makinerive mund të përcaktohen paraprakisht, veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për defekte të fshehura ose probleme që evidentohen vetëm pas kontrollit teknik.

Për këtë arsye, është parashikuar kryerja e diagnostikimit teknik për përcaktimin e shkakut të defektit dhe të ndërhyrjes së nevojshme.

Kjo kërkesë synon të shmangë ndërhyrjet e panevojshme dhe zëvendësimin e komponentëve pa një vlerësim teknik paraprak. Në rast se gjatë diagnostikimit evidentohen nevoja shtesë për pjesë këmbimi ose shërbime, ato do të realizohen vetëm pas kërkesës dhe miratimit të Autoritetit Kontraktor dhe në përputhje me kushtet e kontratës.

Kjo mënyrë veprimi garanton kontrollin e Autoritetit Kontraktor mbi ndërhyrjet dhe shpenzimet që lidhen me mirëmbajtjen e mjeteve.

10. Lista e mjeteve

Lista e automjeteve dhe makinerive është përfshirë në specifikimet teknike për të përcaktuar qartë fushën e zbatimit të shërbimeve të mirëmbajtjes.

Flota përfshin automjete të llojeve, viteve të prodhimit dhe karakteristikave të ndryshme, si Mitsubishi, Mercedes Benz Atego, Iveco, Hidromek, Mitsubishi L200, kamion me kazan, fadromë dhe eskavator me zinxhir Volvo.

Përfshirja e listës së mjeteve i jep operatorit ekonomik informacion të mjaftueshëm mbi llojin e mjeteve që do të mirëmbahen dhe mundëson organizimin e kapaciteteve teknike, personelit, pajisjeve dhe pjesëve/materialeve të nevojshme.

Nevojat e përcaktuara për secilin mjet janë hartuar duke marrë në konsideratë gjendjen teknike dhe nevojat e pritshme të mirëmbajtjes, ndërsa gjatë zbatimit të kontratës ndërhyrjet do të kryhen sipas nevojës reale dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Specifikimet teknike janë hartuar me qëllim garantimin e mirëmbajtjes së rregullt, funksionimit të sigurt dhe vazhdimësisë së përdorimit të automjeteve dhe makinerive në administrim të Autoritetit Kontraktor.

Kërkesat për vajrat, filtrat, pjesët e frenimit, gomat, komponentët mekanikë, elektrikë dhe hidraulikë, si dhe shërbimet e diagnostikimit dhe riparimit, janë të lidhura drejtpërdrejt me nevojat teknike të mjeteve të listuara.

Specifikimet synojnë të sigurojnë që ndërhyrjet të kryhen në mënyrë profesionale, me materiale dhe pjesë të përshtatshme, duke parandaluar dëmtimet e mëtejshme, ulur kohën e qëndrimit të mjeteve jashtë funksionit, rritur sigurinë në përdorim dhe garantuar vazhdimësinë e shërbimeve publike.

Përcaktimi i kërkesave teknike është bërë në funksion të performancës dhe funksionalitetit të kërkuar, duke kërkuar përputhshmëri me karakteristikat teknike të mjeteve dhe, sipas rastit, me kërkesat e prodhuesit ose standardet teknike përkatëse, pa synuar kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

NJËSIA E PROKURIMIT